



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “**TOWER**” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L21717003H**

Adresa: *Tiranë, Tiranë, Njësia Bashkiake nr.2, rruga “Fadil Rada”, pallati “Daniela”, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P.*

Procedura e prokurimit: “**E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime**”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **Loti Nr. 2: REF-95207-05-11-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Loti Nr. 2: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Ndërtimi i Aneksit të Stadiumit”, me fond limit: 409 166 (katërqind e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, nga grandi, dhe me afat: 4 (katër) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).**”

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 75, datë 17 Maj 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme së, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “**TOWER**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L21717003H**
Vlera: **341 010 (treqind e dyzet e një mijë e dhjetë) lekë pa TVSH**

2. Operatorin Ekonomik: “**NOVATECH STUDIO**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L01717030C**
Vlera: **340 249.8 (treqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e nëntë pikë tetë) lekë pa TVSH**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “**NOVATECH STUDIO**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L01717030C**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se çmimi i ofertuar nga ana Juaj, është nën tarifën minimale përlogaritur në zbatim të VKM-së Nr.354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit” për këtë objekt prokurimi, si rrjedhojë oferta Juaj refuzohet.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme :

a) Në rastet e përvojës së ngjashme të realizuara me institucione shtetërore.

- Vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës dhe faturat tatimore të shitjes ku të jetë e përcaktuar koha e shërbimeve, vlera e realizuar si dhe vërtetim e realizimit me sukses të kontratës.

b) Në rastet e përvojës së ngjashme të realizuara me subjektet private.

- Faturat tatimore shitjeje ku të jenë të shënuara saktë datat, shërbimet e realizuara, sasi të shumta si dhe emri dhe nënshkrimi i personit blerës.”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, në shkresën e paraqitur “Referencë për kryerje shërbim konsulencë “Mbikqyrje punimesh ndërtimi” i referohet një kontrate të lidhur në vitin 2015, tej afatit 3 (tre) vjeçar nga data e zhvillimit të procedurës, dhe nuk jepet informacion për kohën e kryerjes së shërbimit.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “b” të pikës 2.3.4/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”, stafi inxhinierik si më poshtë:

- *Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- *Minimumi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik*
- *Minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeodet*
- *Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi”*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për disponimin e 1 (një) inxhinieri Mjedisi në stafin e tij teknik.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“TOWER”** Sh.p.k, me seli: *Tiranë, Tiranë, Njësia Bashkiake nr.2, rruga “Fadil Rada”, pallati “Daniela”, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P*, me numër Nipt-i: **L21717003H**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **341 010 (treqind e dyzet e një mijë e dhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** (*Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike*), me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga momenti i përfundimit të afatit të ankesave prej **7 (shtatë) ditësh** nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) faqja zyrtare e APP-së/ ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën (në rast se do të ketë).

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 *“Për prokurimin Publik¹”*.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **28.05.2021**

Ankesa: **Ankesa për dokumentet e tenderit nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor